

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR LOBIMIN”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për Lobimin” ka për qëllim krijimin e një kuadri ligjor gjithëpërfshirës dhe të qartë për rregullimin e veprimtarisë së lobimit në Republikën e Shqipërisë. Ky kuadër ligjor synon të sigurojë transparencë, llogaridhënie dhe mbikëqyrje efektive të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë ndikim mbi proceset e vendimmarrjes publike.

Miratimi i këtij projektligji përbën një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të demokracisë dhe shtetit të së drejtës, duke i mundësuar publikut, institucioneve dhe mediave të kenë një pasqyrë të qartë mbi ndërveprimet dhe ndikimet që ushtrohen nga persona fizikë ose juridikë në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes. Përmes kësaj kornize ligjore, synohet **rregullimi dhe** formalizimi i një fushe që deri më tani ka qenë e pambuluar nga legjislacioni shqiptar, duke reduktuar hapësirat për ndikime të padrejta në nismat ligjvënëse dhe në politikat publike.

Projektligji synon të përmirësojë mjedisin politik dhe administrativ në vend, përmes forcimit të mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes mbi veprimtarinë e lobimit, si dhe të kontribuojë në rritjen e besimit të qytetarëve në institucionet shtetërore dhe në proceset vendimmarrëse. Ai është në përputhje të plotë me standardet e Bashkimit Evropian për transparencë, integritet dhe sundim të ligjit, duke adresuar një nga kriteret thelbësore të procesit të integrimit evropian të Shqipërisë.

Projektligji “Për Lobimin” është pjesë përbërëse e paketës ligjore “Antikorrupsion”, që zbatohet në kuadër të politikave shtetërore për forcimin e integritetit publik dhe parandalimin e korrupsionit, të përcaktuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, të miratuar me vendimin nr. 736, datë 13.12.2023, të Këshillit të Ministrave. Ky dokument shënon një nga pikët hyrëse të grupkapitullit “Themeloret” në kuadrin e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Nëpërmjet regjistrimit të detyrueshëm të lobistëve dhe krijimit të Regjistrimit të Lobimit, projektligji synon të garantojë transparencë të plotë dhe gjurmueshmëri të çdo ndërveprimi ndërmjet sektorit publik dhe atij privat që synon të ndikojë në proceset e politikëbërjes. Kjo qasje do të krijojë një mjedis të hapur, të drejtë dhe të verifikueshëm, ku qytetarët, institucionet dhe mediat mund të monitorojnë se kush, për kë dhe me çfarë qëllimi zhvillohet veprimtaria lobuese. Në këtë mënyrë, rreziku i ndikimeve të paligjshme, korrupsionit apo konflikteve të interesit reduktohet ndjeshëm.

Miratimi dhe zbatimi i këtij ligji do të kontribuojë në rritjen e besimit të publikut ndaj institucioneve shtetërore dhe proceseve demokratike, duke forcuar ndjesinë e përgjegjësisë dhe etikës publike. Ky besim është thelbësor për konsolidimin e demokracisë funksionale dhe përfshirjen më të gjerë të qytetarëve në proceset politike dhe publike. Në këtë aspekt, projektligji shënon një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një shteti modern dhe të qëndrueshëm, që respekton integritetin institucional dhe promovon sundimin e ligjit.

Një nga objektivat themelore të projektligjit është krijimi i mekanizmave efektivë për administrimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë lobuese. Ai parashikon instrumente të qarta për regjistrimin dhe raportimin e lobistëve, si dhe vendos kompetenca institucionale për monitorimin dhe zbatimin e ligjit, përfshirë edhe sanksione administrative në rast shkeljesh. Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative në këtë drejtim është kusht i domosdoshëm për zbatimin efektiv të ligjit dhe garantimin e një procesi të drejtë, të paanshëm dhe të verifikueshëm.

Projektligji është konceptuar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira evropiane për rregullimin e lobimit. Ai mbështetet në analizën ligjore paraprake të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit, në bashkëpunim të ngushtë me asistencën teknike të Këshillit të Evropës në Tiranë, dhe reflekton përputhshmëri me Rekomandimin CM/Rec(2017)2 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës dhe Rekomandimin e OECD-së mbi Transparencën dhe Integritetin në Lobim dhe Ndikim.

Në përfundim, projektligji “Për Lobimin” synon të krijojë një sistem të rregulluar, transparent dhe të besueshëm të ndërveprimeve ndërmjet sektorit publik dhe privat, si pjesë e qasjes së gjerë të Qeverisë për forcimin e integritetit publik dhe parandalimin e korrupsionit në Shqipëri.

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është në përputhje të plotë me Programin e Qeverisë, Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 dhe Planin e saj të Veprimit 2024-2026, të miratuar me Vendimin nr. 859, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave. Në të njëjtën kohë, nevoja për ndërmarrjen e kësaj nisme ligjore buron drejtpërdrejt nga angazhimet e përcaktuara në vendimin nr. 736, datë 19.12.2023, “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës”, ku rregullimi i veprimtarisë së lobimit identifikohet si një ndër masat prioritare për forcimin e integritetit institucional dhe transparencës në proceset vendimmarrëse publike.

Ky proces vjen gjithashtu në përgjigje të gjetjeve të evidentuara në Raportin e Screening për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, i cili thekson se kuadri ligjor shqiptar në fushën e luftës kundër korrupsionit mbetet vetëm pjesërisht i harmonizuar me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe me standardet përkatëse ndërkombëtare.

Duke marrë në konsideratë se Shqipëria ndodhet në një fazë kyçe të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian, e cila përfshin ndërmarrjen e një pakete të gjerë reformash në fushën e sundimit të ligjit dhe antikorrupsionit, miratimi i ligjit për lobimin është identifikuar nga Komisioni Evropian si një nga prioritetet kryesore për përparimin e mëtejshëm në negociatat e anëtarësimit.

Në këtë kuadër, projektligji “Për Lobimin” përbën një instrument të domosdoshëm për krijimin e një kuadri të qartë, të konsoliduar dhe në përputhje me standardet e BE-së, që do të garantojë transparencë dhe llogaridhënie në ndërveprimet e grupeve të interesit me institucionet publike, si dhe do të forcojë besimin e qytetarëve në shtet dhe në procesin e integritetit evropian të vendit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Një nga përparësitë kryesore të këtij projektligji është promovimi i transparencës dhe llogaridhënies së plotë në proceset e vendimmarrjes publike. Veprimtaritë lobuese që synojnë të ushtrojnë ndikim në fushat politikëbërëse dhe administrative do të jenë objekt i regjistrimit, monitorimit dhe raportimit të vazhdueshëm, duke mundësuar një sistem të unifikuar dhe të besueshëm kontrolli mbi personat dhe subjektet, fizikë apo juridikë, që ndikojnë në hartimin dhe zbatimin e politikave publike. Ky mekanizëm do të garantojë transparencë maksimale dhe ndjekje të plotë të veprimtarisë lobuese, duke siguruar që çdo ndërveprim të jetë i dokumentuar dhe i verifikueshëm.

Projektligji ka gjithashtu një ndikim të drejtpërdrejtë në luftën kundër korrupsionit, pasi parashikon që çdo ndikim mbi proceset vendimmarrëse të jetë i deklaruar, i gjurmueshëm dhe i kontrollueshëm nga institucionet kompetente. Kjo qasje synon të parandalojë ndikimet e paligjshme dhe konfliktet e interesit, duke e bërë ndërveprimin ndërmjet grupeve të interesit dhe institucioneve publike më transparent dhe më të përgjegjshëm.

Në këtë mënyrë, miratimi dhe zbatimi i këtij ligji do të kontribuojnë drejtpërdrejt në përmbushjen e kriterëve kyçe të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit dhe integritetin në administratën publike, si dhe në rritjen e besimit të qytetarëve në institucionet shtetërore dhe proceset demokratike.

Mungesa e një kuadri ligjor të posaçëm për lobimin krijon një boshllëk normativ që lejon ushtrimin e ndikimeve nga persona apo grupe interesi në mënyrë jo të rregulluar dhe pa mekanizma të përcaktuar për transparencë, raportim dhe mbikëqyrje. Kjo situatë ekspozon proceset vendimmarrëse ndaj risqeve të mungesës së transparencës dhe të konfliktit të interesit, duke ndikuar në perceptimin publik për integritetin institucional dhe duke evidentuar nevojën për një qasje të qartë ligjore që siguron përgjegjshmëri, standarde të barabarta veprimi dhe harmonizim me praktikën e Bashkimit Evropian.

Miratimi dhe zbatimi i këtij projektligji do të sjellë një transformim të rëndësishëm në sistemin politik dhe administrativ të Shqipërisë, duke vendosur standarde të reja transparence dhe përgjegjësie.

Regjistrimi i detyrueshëm i lobistëve, deklarimi i aktiviteteve dhe burimeve të financimit të tyre, si dhe raportimi periodik i veprimtarisë lobuese, do të krijojnë një mjedis të qartë dhe të parashikueshëm ligjor, në të cilin proceset e lobimit do të zhvillohen në mënyrë të hapur dhe të verifikueshme.

Ky sistem do t'u mundësojë qytetarëve, mediave dhe shoqërisë civile të kenë akses të plotë në informacionet mbi ndikimet dhe interesat që ushtrohen mbi institucionet publike, duke i forcuar rolin e tyre në mbikëqyrjen demokratike dhe kontrollin publik.

Në këtë mënyrë, ligji do të kontribuojë në uljen e ndjeshme të mundësive për abuzim dhe ndikime të papërshtatshme me interesin publik, duke krijuar një ambient institucional më të qëndrueshëm dhe më të besueshëm.

Në kuadër të përpjekjeve të Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, miratimi i këtij projektligji përfaqëson një hap të domosdoshëm drejt përmbushjes së standardeve të BE-së për transparencë, integritet dhe sundim të ligjit në administratën publike.

Zbatimi i tij do të përmirësojë qeverisjen, klimën institucionale dhe perceptimin ndërkombëtar të vendit, duke e pozicionuar Shqipërinë si një shtet me institucione të hapura ndaj llogaridhënies publike.

Ky projektligj përbën një instrument thelbësor për ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe efikas për veprimtaritë lobuese në Shqipëri. Ai do të:

- forcojë integritetin institucional dhe përgjegjshmërinë publike;
- përmirësojë klimën e besimit ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve;
- rrisë transparencën në vendimmarrjen publike; dhe
- përforcojë proceset demokratike dhe shtetin e së drejtës.

Në këtë mënyrë, projektligji “Për Lobimin” shënon një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një qeverisjeje më të hapur, më të drejtë dhe më të qëndrueshme, duke e afruar më tej Shqipërinë me standardet e Bashkimit Evropian dhe me parimet themelore të demokracisë moderne.

IV. VLERËSIMI I LIGJISHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj hartohet në mbështetje të neneve 78 dhe 83, paragrafi 1, të Kushtetutës.

Në zbatim të vendimit nr. 29, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin” pika 3, gërma “b”, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin është autoriteti i deleguar për propozimin e këtij projektligji, ndaj edhe nisma e propozuar, paraqitet si një iniciativë për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Ministrave, në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës.

Projektligji i propozuar është në përputhje edhe me parimet e përgjithshme të legjislacionit vendas e ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 7 krerë dhe 33 nene.

Kreu I, përcakton dispozitat e përgjithshme:

Kreu I përcakton dispozitat e përgjithshme, duke përfshirë objektin, qëllimin, fushën e veprimit dhe përkufizimet kryesore lidhur me lobimin. Projektligji ka për qëllim të sigurojë transparencë, integritet dhe llogaridhënie në proceset e vendimmarrjes publike, përmes rregullimit të marrëdhënieve mes lobistëve dhe institucioneve publike. Ky projektligj do të zbatohet për një gamë të gjerë zyrtarësh publikë në nivel qendror dhe vendor, si dhe për çdo subjekt që synon të ndikojë në vendimmarrjen publike. Konkretisht, projektligji parashikohet të zbatohet për të gjithë aktorët që përfshihen në procesin e lobimit, përfshirë anëtarët e Kuvendit gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre ligjvënëse, anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe funksionarët politikë pranë tyre, nëpunësit e administratës publike me kompetenca vendimmarrëse, funksionarët e zgjedhur dhe të emëruar në nivel vendor, si dhe punonjësit e njërive të vetëqeverisjes vendore dhe të enteve publike apo shoqërive me kapital shtetëror që ushtrojnë funksione me karakter publik.

Gjithashtu, në këtë kre janë përfshirë përkufizime të qarta për terma, si lobim, lobist, përfitues i lobimit dhe vendimmarrje publike, si dhe është përcaktuar roli i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), si autoritet përgjegjës. Veprimtaria e lobimit dhe marrëdhëniet që burojnë prej saj udhëhiqen nga disa parime themelore, përfshirë parimin e ligjshmërisë, transparencën, llogaridhënien, integritetin, paanshmërinë, pavarësinë, barazinë dhe mbrojtjen e interesit publik.

Kreu II përcakton se veprimtaria e lobimit mund të ushtrohet vetëm nga persona fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, të cilët janë të regjistruar në Regjistrin e Lobimit, në përputhje me kërkesat e këtij ligji. Në këtë kre, parashikohen kritere të qarta ndaluese që e përjashtojnë një individ ose subjekt juridik nga ushtrimi i lobimit, nëse ai është dënuar për vepra penale të rënda, ka detyrime tatimore të pashlyera, është në proces falimentimi apo likuidimi, ka ushtruar lobim pa u regjistruar me parë në Regjistrin e Lobimit apo nuk ka përmbushur detyrimet ligjore për deklarim dhe raportim të konfliktit të interesit.

Gjithashtu, në këtë kre janë përcaktuar disa veprimtari që nuk konsiderohen si lobim, përfshirë ushtrimin e të drejtave themelore demokratike, pjesëmarrjen në konsultime publike pa pagesë, veprimtaritë kërkimore ose akademike, komunikimet ndërinstitutionale, aktivitetet e ligjshme të partive politike, shkrimet apo opinionet mediatike, si dhe përfaqësimi në procedura gjyqësore. Po ashtu, deklaratat e organizatave jofitimprurëse që lidhen me misionin e tyre nuk konsiderohen lobim, për sa kohë nuk financohen apo kryhen në interes të një pale të tretë.

Në Kreu III përcaktohen rregulla dhe procedura për regjistrimin e lobistëve në Regjistrin e Lobimit, një bazë të dhënash publike e administruar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Regjistri përmban të dhëna mbi identitetin e lobistëve, përfituesit e lobimit, temat e veprimtarisë së tyre dhe kontaktet me zyrtarët publikë. Për të ushtruar lobim, kërkesit paraqesin një kërkesë të shoqëruar me dokumentacion të detajuar që vërteton përmbushjen e kushteve ligjore. KDIMDP shqyrton kërkesën, merr vendim për regjistrim ose refuzim dhe ka përgjegjësi për përditësimin dhe publikimin e të dhënave.

Gjithashtu, ky kre përcakton edhe arsyet për refuzimin e regjistrimit dhe heqjen nga regjistri, të cilat lidhen me shkelje të kushteve ligjore, paraqitje të të dhënave të pavërteta, ndalime ligjore të mëparshme ose përfundim të veprimtarisë ligjore të subjektit. Vendimet për regjistrim apo heqje janë të arsyetuara, i komunikohen palës dhe publikohen në faqen zyrtare të KDIMDP. Subjektet e prekur nga vendimi kanë të drejtë ankimi brenda afateve të përcaktuara. Kreu III synon të garantojë një sistem të hapur, të kontrollueshëm dhe të besueshëm për identifikimin dhe monitorimin e veprimtarisë së lobimit në Shqipëri.

Kreu IV përqendrohet në mënyrën e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarisë së lobimit, duke vendosur detyrimin për lidhjen e një kontrate të shkruar ndërmjet lobistit dhe përfituesit, përveç rasteve kur lobimi kryhet në interes të drejtpërdrejtë të vetë lobistit. Kontrata duhet të përmbajë të dhëna identifikuese, objektin, afatet dhe shpërblimet, duke përjashtuar çdo formë shpërblimi të kushtëzuar nga rezultati (*success fee*). Lobistët kanë detyrimin të dorëzojnë kontratat, informacionin mbi përfituesin, dhe çdo ndryshim përkatës në një afat të caktuar pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Përfituesi i lobimit mban përgjegjësi të përbashkët për saktësinë e informacionit të raportuar dhe është i detyruar të bashkëpunojë me KDIMDP.

Gjithashtu, projektligji përcakton të drejtat dhe detyrimet e lobistëve, duke garantuar qasje të barabartë në institucionet publike, pjesëmarrje në proceset e konsultimit dhe të drejtën për t'u ankuar në rast të pengesave të pajustificuara në ushtrimin e ligjshëm të veprimtarisë së tyre. Lobistët janë të detyruar të raportojnë një herë në gjashtë muaj mbi burimet financiare dhe shpenzimet për lobim, të respektojnë standardet e etikës dhe Kodin e Sjelljes, të ruajnë dokumentacionin për të paktën pesë vjet dhe të mos përdorin forma të paligjshme ndikimi. Mbledhja dhe përdorimi i informacionit duhet të bazohet vetëm në burime të hapura dhe të ligjshme, duke respektuar rregullat mbi të dhënat personale dhe sekretet tregtare. Mosrespektimi i këtyre detyrimeve sjell pasoja administrative dhe ligjore.

Kreu V përcakton kufizimet dhe ndalimet që synojnë të parandalojnë konfliktin e interesave në veprimtarinë e lobimit. Ish-zyrtarët publikë që kanë ushtruar funksione vendimmarrëse, përfshirë ministra, deputetë dhe drejtues institucionesh të pavarura, nuk mund të ushtrojnë veprimtari lobimi për një periudhë dyvjeçare pas largimit nga detyra, veçanërisht në institucionet ku kanë shërbyer ose mbi çështje për të cilat kanë pasur kompetenca. Ata ndalohen gjithashtu të përdorin informacione konfidenciale për përfitime personale. Po ashtu, ligji ndalon lobimin në përfaqësim të shteteve ose institucioneve të huaja kur kjo bie ndesh me interesin publik, sigurinë kombëtare apo ligjet për financimin politik, duke parashikuar një shqyrtim të posaçëm për çdo kontratë të tillë.

Në funksion të ruajtjes së integritetit dhe transparencës, ndalohet lobimi në rrethana që krijojnë konflikt interesi për vetë lobistin apo për persona të lidhur me të në mënyrë familjare apo ekonomike. Lobisti është i detyruar të vetëdeklarojë çdo situatë potenciale konflikti përpara se të

angazhohet në një aktivitet lobimi dhe, në rast të mospërbushjes së këtij detyrimi, i nënshtrohet sanksioneve administrative, përfshirë heqjen e përkohshme nga Regjistri i Lobimit.

Në Kreun VI, parashikohen dizpoyita lidhur me kompetenca mbikëqyrëse të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit mbi lobimin, duke kontrolluar që veprimtaritë e lobimit të jenë në përputhje me regjistrin dhe dispozitat ligjore. KDIMDP ka të drejtë të kërkojë informacione nga lobistët dhe përfituesit, të verifikojë dokumentacionin dhe të marrë sqarime nga zyrtarët publikë. Në rast se konstaton shkelje, KDIMDP merr masa administrative dhe raporton publikisht një herë në vit për rezultatet e mbikëqyrjes. Gjithashtu, autoriteti verifikon saktësinë e të dhënave të regjistruara në Regjistrin e Lobistëve dhe kërkon nga lobistët korrigjimin e pasaktësive brenda një afati të caktuar, përndryshe subjekti hiqet nga regjistri.

Në këtë kre parashikohet gjithashtu detyrimi i zyrtarëve publikë për të raportuar çdo kontakt me lobistët brenda 15 ditëve, duke përfshirë informacionet kryesore, si identiteti i lobistit, data dhe tema e diskutimit. Këto raporte verifikohen nga KDIMDP dhe publikohen në Regjistrin e Lobimit, duke respektuar legjislacionin në fuqi për sekretin shtetëror dhe të dhënat personale. Mosdeklarimi ose raportimi i pasaktë i kontakteve lobuese ndëshkohet me gjoba dhe masa të tjera administrative, si dhe ndalime të përkohshme nga veprimtaria lobuese.

Për shkelje të ndryshme të ligjit parashikohen gjoba nga 100,000 deri në 500,000 lekë, si dhe masa të tjera si ndalimi i përkohshëm i veprimtarisë së lobimit. Vendimet e KDIMDP mund të ankimohen në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë brenda 30 ditëve, megjithëse ankimi nuk pezullon ekzekutimin e tyre, përveç në raste të veçanta. Autoritetet publike kanë detyrimin ligjor të bashkëpunojnë me KDIMDP dhe të ofrojnë informacionet e nevojshme, ndërsa refuzimi i bashkëpunimit konsiderohet shkelje administrative dhe ndëshkohet sipas ligjit.

Kreu VII i këtij ligji përcakton dispozitat e fundit. Brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi, Këshilli i Ministrave dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kanë përgjegjësinë të miratojnë aktet nënligjore të nevojshme. Këto akte do të përcaktojnë procedurat për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e Regjistrit të Lobistëve, format e raportimit dhe publikimit të të dhënave, si dhe rregullat e etikës dhe Kodin e Sjelljes që duhet të ndiqen gjatë veprimtarisë së lobimit.

Gjithashtu, Komisioneri është i detyruar të ndërmarrë të gjitha masat administrative, teknike dhe organizative për ngritjen dhe funksionimin e mekanizmave të nevojshëm për zbatimin e ligjit brenda këtij afati kohor. Ligji hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, anëtarët e Kuvendit, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre ligjvënës, anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe funksionarëve politikë pranë tyre, nëpunësit e administratës publike që

ushtrojnë funksione vendimmarrëse, funksionarët e zgjedhur dhe të emëruar në nivel vendor dhe punonjësit e njësive të vetëqeverisjes vendore që ushtrojnë funksione vendimmarrëse, si dhe nëpunësit e enteve publike dhe shoqërive tregtare me kapital shtetëror, institucioneve dhe personave të tjerë juridikë që ushtrojnë funksione ose kompetenca me karakter publik.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QE KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji u hartua nga Grupi Ndërinstitucional i Punës, sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 104, datë 17.7.2025, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen dhe hartimin e projektligjit “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë”, i kryesuar nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe i përbërë nga anëtarë të institucioneve: Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Departamenti i Administratës Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në të njëjtën kohë në cilësinë e sekretariatit teknik të Grupit Ndërinstitucional të Punës, ka asistuar dhe përgatitur paketën e plotë të projektligjit, në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësues nga institucione në statusin e të ftuarit. Hartimi i projektligjit u mbështet dhe u konsultua ngushtësisht nga ekspertët e fushës, përvoja e të cilëve ka qenë një vlerë e shtuar gjatë procesit të hartimit, si dhe nga asistenca e drejtpërdrejtë teknike e zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë. Në datë 21 korrik 2025, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit së bashku me ekspertin Këshillit të Evropës, ka prezantuar në një tryezë të hapur diskutimi analizën ligjore të kryer, e cila hodhi bazat për hartimin e projektligjit. Dhe në vijim, përgjatë muajve shtator – tetor 2025, projektligji i hartuar u nda për vlerësim me këtë ekspertizë, e cila u finalizua me një takim pune online, në datë 16 tetor 2025. Pjesë e tekstit të projektligjit janë në reflektim të rekomandimeve të dhëna nga asistenca teknike.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji pritet të ketë efekte financiare për buxhetin e shtetit, të cilat aktualisht janë në proces vlerësimi. Me miratimin e projektligjit për lobimin do të krijohet regjistri për lobimin, si një mekanizëm monitorimi dhe transparence i veprimtarisë lobuese. Ky proces do të kërkojë alokimin e fondeve për teknologjinë dhe stafin që do të administrojnë këtë sistem. Gjithashtu, do të nevojiten burime njerëzore shtesë për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe për hetimin e çdo shkeljeje të mundshme.

PROPOZUESI

**MINISTRI I SHTESTIT PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN**

ADEA PIRDENI